



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2624 prot.

Shkodër, më 17.07.2019

V E N D I M

Nr. 247, datë 17.07.2019

**"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË LABORATORIT TË TRAJNIMEVE
TË EDUKIMIT TË VAZHDUAR"**


Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 37 pika 1, neni 38 pika 1/d, Statutit të USH-së neni 17 pika 1, pika 6/r, dhe me propozim të Fakultetit të Shkencave të Edukimit (Shkresë nr.2465, datë 15.07.2019), Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në mbledhjen e tij të datës 17.07.2019


V E N D O S I

1. Miratimin e e Rregullores së Laboratorit të Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar (LTEV) (bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohen Zv.Rektori, Drejtorja e Kurrikulave, kërkimit shkencor dhe standardeve, Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.dr. Adem BEKTESHI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

**RREGULLORE E LABORATORIT
TË TRAJNIMEVE TË EDUKIMIT TË VAZHDUAR
(LTEV)**

Korrik 2019

Sheshi 2 Prilli, Shkodër, +355(22)800651, <http://www.unishk.edu.al>, info@unishk.edu.al



Neni 1

Objekti

Laboratori ka për qëllim ofrimin e moduleve, trajnimeve të akredituara dhe certifikimin për mësuesit në arsimin parauniversitar në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

LTEV organizon dhe zhvillon veprimtari trajnuese dhe kualifikuese për mësuesit në shërbim. Drejtimet kryesore të punës të këtij laboratorit përqendrohen në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikatat e zhvillimit profesional të mësuesve etj.

Neni 2

Baza ligjore

Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar (LTEV) u krijua bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 69/2012 datë 21.06.2012 “Për arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, në Udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017, Statutin e Universitetit të Shkodrës “L. Gurakuqi” datë 02.03.2018, kreu II, neni 8 pika 1/c, neni13, dhe Memorandumin e Mirëkuptimit mbi Funksionimin e Qendrave të të Nxënimit gjatë gjithë jetës të nënshkruar nga 8 universitetet shqiptare në kuadër të projektit TEAVET (ERASMUS +).

Neni 3


Literatura e LTEV

LTEV është një qendër bashkohore për kualifikimin e personelit pedagogjik në shkollat e qarkut të Shkodrës dhe më gjerë. Ajo ofron module trajnimi ku mund ta gjejnë veten shumica e profileve të mësuesve në shërbim, si programe që mbështesin dhe sigurojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies, përsosjen e saj, zbatime të risive në fushën e mësimdhënies etj. Modulet e kualifikimit pasurohen dhe përsosen vazhdimisht në përputhje dhe në shërbim të ndryshimeve në arsimin parauniversitar.

LTEV ka një literaturë të specializuar dhe bashkëkohore në ndihmë të kualifikimit të mësuesve të profileve të ndryshme.

Neni 4

Fusha e veprimit



Veprimtaria e Laboratorit Trajnimeve të Edukimi të Vazhduar e mbështet veprimtarinë e saj në Udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017, për “Funksionimin e Sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të Punonjësve Arsimorë”.

Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore mbështetet në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 81 Programet e studimeve të formimit të vazhduar dhe në Ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IX, Neni 56, Pika 2. “Mësuesi ka të drejtë t’i krijohen mundësi për zhvillim profesional”.

Institucioni arsimor planifikon zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit.

Format e zhvillimit profesional janë: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata.

Neni 5

Bashkëpunimet

LTEV siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtorinë arsimore rajonale dhe me zyrat arsimore në rrethe për evidentimin e kërkesave dhe për efektivitetin e programeve trajnuese që ofron ajo.

Po ashtu, ajo bashkëpunon dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, të cilat ushtrojnë veprimtari në këto fusha.

LTEV vendos marrëdhënie bashkëpunimi dhe shkëmbim përvoja me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë Shqipërisë me miratim të Rektorit të USH-së.



Neni 6

Vendodhja e LTEV

LTEV ndodhet në Godinën e Rektoratit (kati i tretë), e cila ka një infrastrukturë moderne për kualifikimin e mësuesve dhe është pjese e Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

Neni 7

Përbërja e trajnuesve

Trajnues janë pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë mësimdhënieje nga departamentet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja etj., sipas profileve që mbulojnë.

Neni 8

Fushat e trajnimeve

LTEV ofron trajnime në mësuesi për arsimin parauniversitar por edhe për pedagogët e rinj që rekrutohen në fushat e pedagogjisë; mësimdhënies dhe TIK bashkohore në mësimdhënie dhe stafin akademik të departamenteve në përputhje me misionin e Laboratorit

Neni 9

Bordi Drejtues

Bordi Drejtues i Laboratorit të Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar ka në përbërje të tij:

1. Rektori i USH-së
2. Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit
3. Dekanin e Fakultetit të Shkencave Shoqërore
4. Dekanin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja
5. Dekanin e Fakultetit të Shkencave Natyrore
6. Përfaqësuesi i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë të USH.
7. Përgjegjësi e LTEV.
8. Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulave, Standardeve, Kërkimit Shkencor dhe Sigurimit të Cilësisë
9. Kryesekretaria mësimore



Neni 10

Funksionet e Bordit Drejtues

Bordi shqyrton aktivitetin dhe merr vendime të cilat janë në përputhje me strategjitë e zhvillimit të universitetit dhe synon që përveç trajnimeve të mësuesve parauniversitar të realizojë trajnime për pedagogët e rinj dhe stafin akademik të USH.

Vendimet miratohen me shumicë votash dhe dalin me firmën e Kryetarit të Bordit të LTEV.

Shpërndarja e të ardhurave (për pedagogët trajnues, të ardhura për USH dhe mbulimin e kostove administrative të LTEV), detajohet nga Bordi Drejtues i LTEV dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të USH që i propozohet nga Senati Akademik sipas përcaktimeve ligjore.

Neni 11

Tarifat

Tarifa për pjesëmarrje në trajnime për mësuesit e arsimit parauniversitar përcaktohet çdo vit akademik me vendim të Bordit të Administrimit të USH.

Numri minimal i pjesëmarrësve të zhvillimit të trajnimeve në LTEV duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjetë).

Tarifa paguhet në banka të nivelit të dytë ose në çdo Filial i Postës Shqiptare për llogari të USH-së.

Neni 12

Realizimi i trajnimeve.

Përgjegjësi i LTEV mban lidhje me portalin e trajnimeve në IZHA, plotësimin e tij dhe korrespondencën me Sekretariatit e KAPT-it në IZHA.

Aplikimet do të bëhen online në portalin: trajnime.arsimi.gov.al , në zbatim të vendimeve që do të marrë bordi drejtues i LTEV-së, çdo vit akademik, ku do të përcaktohen, modulet, periudha dhe oraret e zhvillimit të trajnimeve.

Njoftimi për sesionet e trajnimve i dërgohet çdo DAR/ZA-je dhe bëhet publike.

Të dhënat për regjistrim gjenerohen automatikisht në sitemin e LTEV.

Trajnimet zhvillohen në sesione të rregullta gjatë vitit akademik sipas një grafiku që i dërgohet çdo institucioni arsimor në adresën e tij zyrtare.

Forma e trajnimit për të gjitha modulet janë: trajnim i drejtpërdrejtë (konsultime, bashkëbisedime), online (njoftimet, literatura, pyetjet etj.) dhe në punën krijuese vetjake të çdo mësuesi (detyra, projekte etj.)

Neni 13

Lëshimi i certifikatave

Në fund të trajnimit, mësuesit pajisen me certifikatë zyrtare, e cila përmban: titullin e modulit, numrin e krediteve dhe përmbajtjen e modulit.

- LTEV dërgon brenda 20 ditëve nga data e zhvillimit të trajnimit, me e-mail dhe me shkresë zyrtare, në sekretarinë e KAPT-it, numrin dhe listën e punonjësve arsimorë të certifikuar nga LTEV për çdo modul të akredituar

